# Projekt-Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021

# Statistikat Demografike dhe Sociale

Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

# Organizimi i Statistikave në INSTAT

- Statistikat Demografike dhe Sociale;
- Statistikat e Anketave Prane Familjeve
- Statistikat makroekonomike;
- Statistikat e Ekonomike dhe Biznesit;
- Statistikat e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit dhe Mjedisit;
- Statistikat *multi-domain;*
- Mbështetja për prodhimin statistikor (Regjistrat statistikorë dhe Klasifikimet)

# Statistikat Demografike dhe Sociale

Drejtoria e Statistikave Sociale mbulon fushat që në Program përfshihen nën Temën “Popullsia e Shqipërisë”.

Disa nga këto fusha bazohen kryesisht në burime administrative përsa i përket llogaritjes se treguesve.

- Popullsia
- Arsimi
- Shëndetësia
- Statistikat juridike
- Kultura
- Statistikat gjinore

# Statistikat Demografike dhe Sociale

Drejtoria e Statistikave Sociale mbulon fushat që në Program përfshihen nën Temën "Popullsia e Shqipërisë" brenda programit statistikor.

Disa nga këto fusha bazohen kryesisht në burime administrative përsa i përket llogaritjes së treguesve.

- Popullsia
- Arsimi
- Shëndetësia
- Statistikat juridike
- Kultura
- Statistikat gjinore

# Statistikat Demografike dhe Sociale

## Statistikat e Popullsisë

- Ndërtimi i **Regjistrit statistikor të popullsisë banuese** në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme e cila po ndërton regjistrin e adresave, regjistrin e emigrantëve dhe atë të popullsisë, të cilët mendohet të përfundojnë në vitin 2017. Ky regjister do të ndihmojë:
  - Llogaritjen më të mirë të popullsisë banuese sipas moshës dhe gjinisë
  - Kryerjen e Censusit të ardhshëm të Popullsisë dhe Banesave 2021 bazuar në Regjistrin e Popullsisë sipas standarteve dhe rekomandimeve evropiane



- Në vitin 2017, planifikohet të kryhet për herë të parë **Mikro Censusi**, vrojtim i cili do të përfshijë 10% të popullsisë, në mënyrë që të mundësojë përfaqësimin e ndarjes së re administrative (61 bashkitë). Treguesit të cilët do të llogariten bazuar në rezultatet e mikro censusit do të publikohen në vitin 2018.
- Përmirësimi i **statistikave të azil-kërkuesve dhe të huajve në Shqipëri**, e cila do të mundësohet me rritjen e bashkëpunimit me institucionet përkatëse.

Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

# Statistikat Demografike dhe Sociale

## Statistikat e Arsimit

- Do të bazohen kryesisht në burime administrative - Data-bazën që sigurohet nga Ministria e Arsimit.

  Sistemi i ri elektronik EMIS (Educational Management Information System) do të ndihmojë në konsolidimin e treguesve të arsimit publik e privat, si dhe do të krijojë mundësinë për të llogaritur tregues të rinj si: braktisja e shkollës, etj.

- Për herë të parë INSTAT do të kryejë **Anketën e Arsimit** (Adult Education Survey) e cila jo vetëm do të pilotohet nga ekspertë të Eurostatit me mbështetjen finaciare të projektit IPA 2014 gjatë vitit 2016, por do të shërbejë edhe si vrojtim të cilit do t'i shtohen module të ndryshme që do të sigurojnë tregues për fusha të tjera sociale.
- Implementimi i klasifikimit të nivelit arsimor ISCED 2011



INSTAT Republika e Shqipërisë Instituti i Statistikave

# Statistikat Demografike dhe Sociale

unicef

## Shëndetësia

- Përmirësimi i cilësisë të të dhënave administrative, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin e Shëndetit Publik.
- Përmirësimi i cilësisë në kodifikimin e regjistrimit të shkaqeve të vdekjeve



## Programi i ri Statistikor

- Mundësinë në të ardhmen për të futur ICD-10, i cili do të bëjë të mundur krahasimin me vendet e tjera.
- Përmirësimin dhe shtimin e gamës së treguesve të shëndetësisë duke pasur parasysh edhe afatin kohor të publikit të tyre.

# Statistikat Demografike dhe Sociale



## Statistikat Gjinore

- Do të shtohet vazhdimisht e treguesve të disagreguar sipas gjinisë kryesisht për të dhënat administrative
- Në Programin Statistikor Zyrtar 2017-2021, do të planifikohet **Anketa e Përdorimit të Kohës.**
- Do të përfshihet një modul **për perceptimin e dhunës** në një anketë pranë familjeve, mendohet ADHS e ardhshme. Gjithashtu mund të përfshihet dhe matja e dhunës te fëmijët.
- Do të matet **varfëria relative** sipas gjinisë nëpërmjet rezultateve të SILC.
- Implementimi i anketës së dedikuar për matjen e **hendekut gjinor në pagë.** Kjo anketë është një anketë e re e cila kryhet pranë ndërmarrjeve dhe implementohet nga vendet anëtare.

Statistikat Demografike dhe Sociale

## Statistikat e Kulturës

- Duke filluar nga viti 2017 INSTAT do të përfshijë në PSZ statistikat për kulturën pavarësisht se disa tregues do të përfshihen në botime të ndryshme që sivjet. Këto statistika do të përfshijnë:
- **Numrin e institucioneve dhe aktiviteteve kulturore** të cilat do të jenë të dhëna administrative dhe do të mblidhen nga Ministria e Kulturës;
- **Pjesmarrjen në aktivitete kulturore dhe sportive** të cilat do të mblidhen nëpërmjet anketave pranë familjeve, nëpërmjet një moduli për kulturën i cili mendohet të përfshihet në Anketën e Arsimit (Adult Education Survey);



Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

# Statistikat Demografike dhe Sociale

## Statistikat e Juridike

- Dokumentimi i procesit të mbledhjes dhe përpunimit të statistikave juridike, në mënyrë që të dhënat e publikuara të jenë më të qarta si dhe të sigurohet cilësia e tyre
- Krijimi i bazës së të dhënave për statistikat juridike sipas kërkesave të Eurostatit
- Parashikimi në Programin e ri të Statistikave Zyrtare, memorandume bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe të Burgjeve, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, për të siguruar informacion më të detajuar dhe më të plotë.



# Statistikat Demografike dhe Sociale

Të gjithë treguesit e fushave do të shihen duke bashkërenduar:

1. Me secilin institucion prodhues të tyre
2. Duke konsultuar të gjithë pyetsorët që vijnë nga Eurostat-i dhe UN
3. Duke konsultuar Treguesit e Qëndrueshëm të Zhvillimit (SDG)

**Shembull: Moduli 07.1.43 Siguria dhe Krimet**

Statistikat e krimeve.docx

Treguesit  KRIMET 2017-21 .xlsx

SDGs indicators.pdf

# Statistikat e Anketave Prane Familjeve

# Statistikat e Tregut të Punës dhe Nivelit të Jetesës

- **Moduli 07.1.31 – Punësimi dhe Papunësia**

- **Anketa e Forcave të Punës (AFP)**
  - Objektivi: përshkrimi i madhësisë, strukturës dhe karakteristikave të pjesëmarrësve në tregun e punës,
  - Metodologjia: në përputhje me ILO dhe Eurostat,
  - Periodiciteti: vjetor (nga 2007) dhe e vazhdueshme (nga 2012),
  - Rezultatet: Tremujore dhe vjetore,
  - Niveli: shkallë vendi,
  - Klasifikimet: ISCO – 08 dhe NACE Rev2.
- **Burimet administrative**
  - Burimi: MMSR, ShKP, DPT
  - Treguesit:
    - punësimi në sektorin shtetëror,
    - Punësimi në sektorin privat jo-bujqësor,
    - Papunësia e regjistruar.

# Drejtoria e Statistikave pranë Familjes

- **Moduli 07.1.32 – Fitimet dhe kostot e punës**

- **Anketa e Kostos së Punës (LCS):**
  - Anketë 4-vjeçare që përshkruan në mënyrë të detajuar komponentët e kostos së punës: paga, shpërblime, bonuse, paga në natyrë, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që paguan punëdhënësi.
- **Indeksi i Kostos së Punës (LCI):**
  - Mat zhvillimin afat-shkurtër të kostos për orë që punëdhënësit duhet të përballojnë për të mbajtur në punë punonjësit e tyre.
- **Anketa e Strukturës së të Ardhurave (SES):**
  - Sjell informacion të detajuar dhe të harmonizuar mbi lidhjen e nivelit të kompensimit financiar dhe karakteristikave individuale të punonjësve dhe të punëdhënësve të tyre.
- **Statistika të tjera të lidhura me pagat:**
  - Paga minimale, hendeku gjinor i pagës, fitimet neto dhe shkalla e taksimit të cilat paraqesin fitimet e punonjësve pas heqjes së taksave mbi të ardhurat dhe kontributet sociale nga vlera bruto dhe duke shtuar përfitimet familjare.

- **Moduli 07.1.41 – Anketa e buxhetit të familjes dhe anketa e përdorimit të kohës**

- **Anketa e buxhetit të familjes (HBS)**
  - Objektivi: informacion mbi shpenzimet për konsum të njësive ekonomike familjare me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri, shpenzimet për vetë-konsum, të dhëna për situatën socio-demografike të tyre. Input mbi përditësimin e ICK dhe llogaritjen e Konsumit Final të Familjeve (pjesë e PBB).
  - Periodiciteti: I vazhdueshëm me rezultate vjetore
  - Klasifikimi: COICOP 2012
- **Anketa e përdorimit të kohës (TUS)**
  - Objektivi: informacion i detajuar sesi individët shpenzojnë kohën e tyre, punën e papaguar, aktivitetet jashtë vendit të punës dhe çështjet që lidhen me balancën e punës dhe jetës familjare.
  - Periodiciteti: 10 vjeçar

# Drejtoria e Statistikave pranë Familjes

- **Moduli 07.1.42 – Të ardhurat, përfshirja sociale dhe niveli i jetesës**

- **Anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës (SILC)**
  - Objektivi: informacion mbi të ardhurat, nivelin e arsimit, tregut të punës, situatës familjare dhe kushteve të jeteses.
  - Treguesit:
    - Niveli i varfërisë dhe përjashtimit social;
    - Shpërndarja e të ardhurave dhe varfëria monetare;
    - Niveli i jetesës dhe Privimi material.
  - Periodiciteti:
    - Vjetor
  - Institucionet bashkëpunuese:
- BSH, DPT, ISSH, SHSSH, SHKP, MASH, MSHCV, AMF

# Drejtoria e Statistikave pranë Familjes



- **Moduli 07.1.56 – Mbrojtja sociale (ESSPROS)**

- Baza: të dhënat administrative
  - MSH, MF, MMSR, ISSH, SHSSH.
- Përshkrimi:
  - Tregues të mbrojtjes sociale sipas listës konvencionale me rreziqet ose nevojat që mund të bëhen subjekt i mbrojtjes sociale: kujdesi për sëmundjet/shëndetin, paaftësinë, pleqërinë, të mbijetuarit, familjet/fëmijët, papunësinë, strehimin dhe përjashtimin social të papërfshirë në kategoritë e tjera.
- Sistemi:
  - Sistemi bazë i të dhënave sociale:
    - Të dhënat sasiore – të ardhurat dhe shpenzimet e mbrojtjes sociale sipas skemave dhe gjithsej
    - Informacioni cilësor – metadatat e skemave të mbrojtjes sociale dhe përfitimet e detajuara
  - Moduli mbi numrin e përfituesve të pensioneve
  - Moduli mbi përfitimet neto të mbrojtjes sociale

Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

# Statistikat Makroekonomike

# Statistikat makro-ekonomike

- INSTAT,  në kushtet e kërkesave të zgjerimit si vend kandidat, do të përfshihet më thellë në respektimin e rregullave të Eurostat-ESA2010, duke shkaktuar një ndikim të fortë në statistikat zyrtare të planifikuar për vitet 2017-2021.
- Duke i u referuar kërkesave të Eurostat, Drejtoria e Llogarive Kombëtare ka parashikuar një “roadmap”, duke reflektuar planet per implementimin e sistemit sa më të plotë të Llogarive Kombëtare në Shqipëri sipas ESA 2010. Planet janë sfida, por i japin Statistikave të Shqipërisë një mundësi unike për t’u modernizuar dhe për të kompletuar statistikat  e LLK.

# Programi Transmetimit ESA 2010

**TABELA 6: (Llogaritë financiare sipas sektorëve – vjetore)**
**TABELA 7: (**Bilancet për aktivet dhe pasivet financiare – vjetore)
**TABELA 8: (Llogaritë jo-financiare sipas sektorëve** – tremujore)

**2020:**

**TABELA 20: TABELA 22: (**Klasifikime të kryqëzuara të investimeve (GFCF) sipas degëve dhe aseteve – vjetore):

**2018:**

**TABELA 8: (**Llogaritë jo financiare sipas sektorëve institucionalë– vjetore):
**TABELA 13: (**Llogaritë e familjeve sipas rajoneve, NUTS II – vjetore

**2017:**

TABELA 15:(Tabela Burimeve me çmime bazë përfshi tranformimin me çmime blerje– vjetore)
TABELA 16: (Tabela Burime me çmimet e blerjes – vjetore)
TABELA 17: (Tabela simetrike input-output me çmime bazë)

**2016:**

TABELA 3: (Tabelat sipas degëve – Vjetore)

**2015:**

TABELA 9: (Taksat e detajuara dhe kontribuitet sociale ........ – vjetore)
TABELA 10:(Tabelat sipas degëve dhe rajoneve, NUTS II – vjetore)
TABELA 11: (Shpenzimet e Adm Publike sipas funksionit – vjetore)
TABELA 12: (Tabelat sipas degëve dhe rajoneve, NUTS III – vjetore)

**Shtator 2014: Transmetimet e para**

TABELA 1A: Treguesit kryesorë–vjetore
TABELA 1Q: Treguesit kryesorë – tremujore
TABELA 5: (HFCE sipas qëllimit– vjetore)




K O H A

**INSTAT** **Transmetimi** **EUROSTAT**

# Statistikat makro-ekonomike



- Planet adresojne çështje rreth transparencës dhe standardizimit në sistemet tona dhe proceset për llogaritë kryesore kombëtare vjetore; siç është psh kuadri SUT dhe IOT; llogaritë e sektorit institucional.

- Kryerja njekohesisht e procesit te balancimit me çmime korrente e konstante do të përmirësojë cilësinë statistikore dhe do të mbylle hendekun midis vlersimeve sipas mënyres së prodhimit dhe të shpenzimeve të PBB-së. Integrimi i kuadrit SUT me llogarite e sektorëve institucionale do të sigurojë procese më efikase, duke lejuar më shumë kohë për analizë dhe punë të tjera të zhvillimit, dhe do të mundësojë një nivel shumë më të madh të sigurimit të cilësisë.

# Vlerësime të Reja të Sektorit të Administratës Publike (APU)

- Vlerësime të llogarive të APU dhe nën-sektorëve të saj

- Plotësimi i kërkesave të Procedurës së Deficitit të tejkaluar
  - Vlerësimi i treguesve të Deficitit sipas kërkesave EU
  - Vlerësimi i borxhit sipas kërkesave EU
  - Vlerësimi i ndryshimeve vjetore të Borxhit dhe Deficitit sipas standarteve ESA2010

# Hartimi i Statistikave të financave publike (GFS)

- Përgatitja e llogarive vjetore dhe tremujore për APU të përgjithshme dhe nën-sektorët e saj, përgatitja e procedurave për njoftimin EDP dhe mbikëqyrja e zbatimit të metodologjive përkatëse.

- Vlerësimi i agregateve të lidhura me APU, të cilat janë të përfshira në llogaritë kombëtare.

# Hartimi i Statistikave të financave publike (GFS)

## PSZ 2017-2021, duhet të :

- Përmbajë një modul (seksion) të veçantë në lidhje me statistikat e administratës publike dhe të ndërmarrjeve publike apo kompanitë e kontrolluara nga entet publike, si dhe shërbimet publike.

  - Ky theksim do të shërbejë pa dyshim për mbledhjen e të gjitha të dhënave mbi organizimin, formën ligjore, sektorin e aktivitetit, alokimin e burimeve njerëzore dhe financiare dhe shpenzimet e subjekteve të përmendura

  - Njohjen e produkteve dhe shërbimeve të prodhuara, shpenzimet dhe rezultatet, veçanërisht nën klasifikimet ndërkombetare, si COFOG, etj.

# Statistika koherente të Llogarive Kombëtare

- Rishikimi i tërësisë të të dhënave përkatëse makroekonomike të përpiluara jashtë INSTAT:
  - Banka e Shqipërisë: statistikat financiare dhe monetare, të koordinuara me zbatimin e BPM 6 me ESA 2010
  - Ministria e Financave: manuali GFS i ri 2014 (GFSM) është në përputhje me ESA 2010
- Përmirësimi i aksesit dhe përdorimi i të **dhënave ekzistuese administrative dhe regjistrave**
- Modernizimi i infrastrukturës dhe trajnimi i BNJ

# Problematika të tjera

- Nxitje e veçantë do t'i kushtohet aktiviteteve të lidhura me njohjen dhe monitorimin e instrumentave të dobishme për matjen e ekonomisë së pa-vrojtuar. Problemet e lidhura me këtë fenomen, të tilla si psh nën-deklarimi i të ardhurave nga bizneset, mbi-deklarimi i kostove ndërmjetëse dhe përdorimi i punësimit jo të rregullt, janë të një rëndësie themelore për Llogaritë Kombëtare duke pasur si qëllim kryerjen e vlerësimeve të plota të PBB-së.

- Në këtë pikëpamje, të zhvillojmë vlerësime të disa aktiviteteve të paligjshme (të kultivimit e shpërndarjes të "kanabis stativa", trafikimit të drogës, kontrabandës së duhanit dhe alkoolit, mbështetja dhe shfrytëzimi i prostitucionit, etj fenomene ilegale), që përfaqësojnë një pjesë të prodhimit të të ardhurave kombëtare dhe që nuk janë përfshirë deri më tani në vlerësimet zyrtare.

Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

# Vizioni i Llogarive Kombëtare
# - Integrimi  rrugët e arritjes



# Program Zyrtar i Statistikave



# Statistikat e Ekonomike dhe Biznesit

# Objektivi kryesor i statistikave ekonomike

- Të sigurojnë informacion të besueshëm, të përditësuar, në kohë dhe të krahasueshëm mbi çmimet e konsumit, ndërmarrjet, shkëmbimin e mallrave, etj, për qëllime të hartimit të politikave dhe strategjisë së zhvillimit ekonomik të vendit;
- Të sigurojnë informacion të besueshëm të përditësuar dhe tregues cilësorë nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm dhe harmonizimit me standartet evropiane, krahas treguesve statistikore që lidhen me zhvillimin ekonomik në vend edhe për hartimin e politikave në fusha të veçanta si Industri, Ndërtim, Energji, Transport, Turizëm, Informacion dhe komunikim,etj.
- Të ulë nivelin e mospërgjigjeve të ndërmarrjeve duke rritur përdorimin dhe shfrytëzimin e burimeve administrative të disponueshme për qëllime statistikore dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit të tyre, pa ulur cilësinë e treguesve statistikorë të prodhuar.

# Statistikat Ekonomike përfaqësohen:

- Statistikat e Çmimeve të Konsumit
- Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave
- Statistikat e Ndërmarrjeve
- Statistikat e Energjisë
- Statistikat e Transportit
- Statistikat e Turizmit;
- Statistikat e Kërkim-zhvillimit Shkencor dhe Inovacionit
- Statistikat e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit
- Statistikat e Rregjistrit të Ndërmarrjeve dhe Klasifikimet

# Statistikat e çmimeve të konsumit

- Objektivi:
  - Matja e ecurisë së çmimeve të konsumit nëpërmjet llogaritjes së:
    - Indeksit të Çmimeve të Konsumit;
    - Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK)
    - Matjes së Fuqisë Blerëse
- Të reja:
  - Llogaritja e indeksit të banesave / shtëpive si komponent i IHÇK.
- Burimi informacionit:
  - Statistikor: vrojtim mujor



# Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave

- Objektivi:
  - Të paraqesin informacion statistikor mbi shkëmbimet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera.
- Burimi i informacionit:
  - Administrativ: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.



# Statistikat ndërmarrjeve

- Objektivi:
  - përmbajnë të dhëna të detajuara për strukturën e aktiviteteve ekonomike (jobujqësore)dhe tendencën tremujore të zhvillimit ekonomik, sipas degëve të ekonomisë dhe sipas madhësisë së ndërmarrjeve në nivel vendi.
- Te reja:
  - Vrojtim mbi cmimet e shërbimeve,
  - Tregues rajonale te statistikave strukturore;
- Burimi i informacionit:
  - Statistikor: Vrojtime tremujore dhe vjetore
  - Administrativ: DPT, QKR, ISSH dhe shfrytëzimi

  i burimeve të tjera administrative.



# Statistikat e Energjisë

- Objektivi:
  - Prodhimi i Bilancit të Energjisë Elektrike dhe Bilancit të Përgjithshëm të Energjisë.
- Te reja::
  - Bilanci tremujor i energjisë elektrike, bilanci I lëndëve të tjera energjetike;
- Burimi informacionit:
  - Administrativ: MEI;AKBN;ERE;KESH;

OST;OSHEE;



# Statistika të Transportit

- Objektivi:
  - Informacion mbi transportin e pasagjerëve dhe të mallrave sipas mënyrave të transportit, infrastrukturën e linjave

    rrugore, hekurudhore , inventarin e mjeteve të transportit rrugor,etj
- Të reja:
  - Statistika të transportit rrugor të mallrave dhe pasagjerëve,
  - Statistika të detajuara të inventarit të mjeteve;
- Burim informacioni:
  - Statistikor: vrojtim vjetor;
  - Administrativ: MIT, IT, DPH, AP, ANT, DPSHTR.etj.





# Statistika të Turizmit

- Objektivi:
  - Të prodhojë statistika mbi kapacitetin e njësive akomoduese, turizmin e brendshëm dhe lëvizjen e shtetasve sipas mënyrës së udhëtimit, qëllimit dhe rajonit.
- Të reja:
  - Rregjistri i njësive akomoduese,
  - Tregues të turizmit të brendshëm.
- Burim informcioni:
  - Administrativ: MZHETTS; MPB (DPSH); BSH.
  - Statistikor: Vrojtim mujor.



# Statistika të kërkim zhvillimit dhe inovacionit

- Objektivi:
  - Prodhimi I statistikave te kërkimit shkencor dhe inovacionitn;
- Te reja:
  - Statistika  mbi kerkimin shkencor;
  - Statistika mbi inovacionin.
- Burimi informacionit:
  - Statistikor: vrojtim dy vjecar
  - Administrativ: AKTI dhe institucionet publike.

# Statistika të Treguesve të Shoqërisë së Informacionit

- Objektivi:
  - Matja e treguesve të perdorimit te teknologjise se informacionit dhe komunikimit pranë ndërmarrjeve dhe individeve.
- Te reja:
  - Tregues mbi teknologjine e komunikimit shoqerine e informacionit.
- Burimi informacionit:
  - Statistikor: Vrojtim vjetor;
  - Administrativ: AKEP; etj.



# Statistika të rregjistrit të ndërmarrjeve dhe klasifikimet

- Objektivi:
  - Përditesimi i rregjistrit statistikor të ndërmarrjeve si mjet për vrojtimet statistikore si dhe analiza demografike të popullsisë së ndërmarrjeve.
- Të reja:
  - Tregues demografikë;
  - Ndërmarrjet eurogrup;
- Burimi informacionit:
  - Administrativ: QKB, DPT, ISSH;
  - Statistikor: vrojtime tremujore

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

unicef

# Nisma të reja për zhvillimin e statistikave ekonomike

- Përditësimi i aktiviteteve statistikore në drejtim të plotshmërisë së tyre sipas kërkesave në vend;
- Ndjekja e kuadrit ligjor të integruar mbi statistikat e ndërmarrjeve sipas standarteve evropiane (FRIBS);
- Përfshirja në sistemin e rregjistrit statistikor të ndërmarrjeve të Eurogrup.
- Përdorimi i teknikave moderne dhe shkencore për grumbullimin e informacionit;
- Përmirësimi i afatit kohor të publikimit;
- Rritja e nivelit të përputhshmërisë me statistikat evropiane;
- Matja e cilësisë së treguesve të prodhuar;
- Transmetimi në Eurostat i statistikave ekonomike;
- Rritja e përdorimit të burimeve administrative të vlefshme për të ulur koston e vrojtimeve dhe përmirësuar afatin kohor.

# Statistikat e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit dhe Mjedisit

# Hyrje Bujqësia dhe Mjedisi

- **Drejtoria e statistikave të bujqësisë dhe mjedisit** (DSBM) përcakton, harton, përpunon dhe publikon të gjithë treguesit statistikorë të bujqësisë dhe mjedisit të cilat miratohen në Programin 5 vjeçar të Statistikave Zyrtare dhe në planin vjetor të punës të Institutit të Statistikave;
- Në përbërjen e vet, kjo drejtori organizohet në 3 sektorë. (Sektori i statistikave të tokës dhe prodhimit bimor, sektori i statistikave të blegtorisë, peshkimit dhe Mjedisit, Sektori i Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis;
- Në organizimin sipas sektorëve është patur parasysh që çdo sektor në veprimtaritë e veta të mbulojë sektorët korrespondues institucional dhe të operojë me efektivitet në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave me bazë anketat dhe të dhënat administrative;

# Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Në hartimin e programit të ri të statistikave puna është bazuar në Përmbledhësen e Statistikave Europiane 2015.

Qëllimi kryesor është harmonizimi i statistikave të Bujqësis dhe Mjedisit me ato të BE-së

Statistikat e Bujqesisë dhe Mjedisit perfshihen në fushën: **08 dhe 05**

*Modulet përkatese janë:*

08.4.11 – Statistikat e Bujqësisë

08.4.12 – Statistikat e Peshkimit

08.4.13 – Indikatorët Agro-Mjedisor

08.4.15 – Bujqësia dhe Prodhimet Organike

08.4.41 – Statistikat e Përdorimit dhe Mbulimit të Tokës

08.2.32 – Statistikat e Mbetjeve

08.2.33 – Statistikat e Ujit

08.2.34 – Stastikat e Pyjeve

08.2.35 -- Llogaritë e Integruara për Pyjet dhe Mjedisin

05.1.21 – Llogaritë Monetare në Mjedis

05.1.22 – Llogaritë Fizike në Mjedis

Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

# Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Aktivitetet zbatuese  për realizimin e statistikave të bujqësisë dhe mjedisit janë:

- Vrojtimet 6 mujore dhe vjetore në Bujqësi;
- Vrojtimi i serrave;
- Vrojtimi i Strukturës së Fermave (FSS);
- Vrojtimi i Stukturës së Pemtoreve;
- Vrojtimi i përdorimit dhe mbulimit të Tokës;
- Vrojtimi mbi strukturën dhe tipologjinë e fermës sipas madhësisë ekonomike
- Vrojtim për përdorimin e ujit sipas aktiviteteve ekonomike
- Vrojtim mbi çmimet e input-eve bujqësore

# Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

**Risitë që do të ketë gjatë ketij programi konsistojnë në harmonizimin dhe prodhimin e statistikave të bujqësisë sipas standarteve të BE-së;**

- Struktura dhe tipologjia e fermave sipas madhësisë ekonomike;
- Publikimi i treguesve agro-mjedisore;
- Publikimin e treguesve të bujqësisë organike (përfshihet dhe akuakultura);
- Çmimet e bujqësisë - Toka (përfshirë qeranë)
- Publikimi i stukturës së pemëtoreve;
- Parashikimi i prodhimit të mishit për konsum popullate (përfshihen dhe nënproduktet e mishit);
- Statistikat e mbetjeve industriale sipas aktiviteteve;
- Statistikat e trajtimit te mbetjeve sipas kategorive;
- Numri i subjekteve që trajtojnë mbetjet për riciklim, sipas rajoneve dhe kapaciteti i tyre;

# Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

**Risitë që do të ketë gjatë ketij programi konsistojnë në harmonizimin dhe prodhimin e statistikave të bujqësisë sipas standarteve të BE-së;**

- Statistika për përdorimin e ujit sipas aktiviteteve ekonomike
- Statistika për përdorimin e ujit sipas rajoneve
- Shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit dhe të ardhurat
- Taksat e mjedisit sipas industrisë
- Të mirat dhe shërbimet në mjedis
- Llogaritë e emetimeve në ajër
- Llogaritë fizike në mjedis të ekonomisë
- Llogaritë rrjedhëse fizike të energjisë

# Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

**Institucionet që do të përfshihen:**

- Ministria e Bujqësise, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave (MBZHRAU);
- Ministria e Mjedisit
- Agjensia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR)
- Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore (AKBN)
- Agjensia Kombëtare e Mjedisit
- Agjensia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik Rajonal;
- Ministria e Financave
- Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)
- Ministria  e Energjisë
- Sistemi Veterinar në Shqipëri

Nga këto institucione dhe agjenci statistikore kërkohet jo vetëm kontributi në ndërtimin e një programi statistikor të shëndoshë por dhe planifikimi e koordinimi i aktiviteteve me të gjitha institucionet në varësi të tyre;

# Faleminderit!